




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.08.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-858/15, për z. Kolë Krasniqi, u.d Dekan në Fakultetin Juridik të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, për shkak se zyrtari i lartë ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit të u.d të Sekretarit të Përgjithshëm dhe Përfaqësuesit Ligjor të Universitetit “Haxhi zeka” në Pejë.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Kolë Krasniqi, u.d Dekan në Fakultetin Juridik të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë dhe njëkohësisht u.d Sekretar i Përgjithshëm dhe Përfaqësues Ligjor i Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me z. Kolë Krasniqin në Agjencinë Kundër Korrupsionit për ta njoftuar për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Zyrtari i lartë z. Kolë Krasniqi ka njoftuar zyrtarin e Agjencisë se ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionin të u.d të Sekretarit të Përgjithshëm dhe Përfaqësuesit Ligjor të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë.

Ndërkohë z. Krasniqi ka dërguar një shkresë zyrtare (DPLI-03-02-2190/15), në të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë ka dhënë dorëheqje, dhe tashmë ushtron vetëm një funksion publik atë të u.d të Dekanit të Fakultetit Juridik të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë”.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

